

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: ALFA GLOBE SH.P.K.; Eor Group SH.P.K., Veternik M2, 10 000, Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	04.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **04.12.2023**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **ALFA GLOBE SH.P.K.; Eor Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PLEH ARTIFICIAL**, me Numër të prokurimit: **623-23-10579-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-064-1-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **ALFA GLOBE SH.P.K.; Eor Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PLEH ARTIFICIAL**, me Numër të prokurimit: **623-23-10579-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-064-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **29.11.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-23-10579-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-064-1-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Grup i Operatorëve Ekonomik: **ALFA GLOBE SH.P.K.**; **Eor Group SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PLEH ARTIFICIAL**, me Numër të prokurimit: **623-23-10579-1-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-064-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **29.11.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **04.12.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PËRGGJIGJE PËR PRETENDIMET E TUA ANKIMORE:

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit *B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 3: Licencë për importim dhe eksport të plehrave;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 3: Licenca Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar si Grup i Operatorëve Ekonomik, Licencë për importim dhe eksport të plehrave është dorëzuar vetëm nga ALFA GLOBE SH.P.K. dhe jo nga Secili anëtar i grupit individualisht, ku Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik, thotë:

26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit.

Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.

Po ashtu ne baze te Specifikave teknike te kërkuara tek Përshkrimi i Çmimeve dhe Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Dosjes se Tenderit, Operatori Ekonomik: ALFA GLOBE SH.P.K. nuk posedon Licence për produktin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues Regjistrin e plehrave artificiale, qe lejohen te importohen, qarkullojnë dhe përdoren ne Republikën e Kosovës, bashke me kompanitë e licencuara per plehrat përkatëse, e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural mund ta gjeni ne linkun e mëposhtëm:

[Regjistri_i__plehrave_artificiale_te_regjistruar_ne_MBPZHR_12.09.23.pdf \(mbpzhrks.net\)](#)

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit